



Datë: 30.01.2026
Numër Protokolli: 565/2026

A.nr.1902/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1902/2025, të datës 13.11.2025, të parashtruar nga ankuesi V.H më objekt ankimor “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 30.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1902/2025, e datës 13.11.2025, e parashtruar nga ankuesi V.H.

II. Anulohet Vendimi Ref. DBN-MM- 956/2025, i datës 07.11.2025, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes për anulimin e konkursit më numër të referencës RN00018499.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmarrin çdo veprim të nevojshëm në mënyrë që procedura e pranimi më numër të referencës RN00018499 të vazhdoj më intervistën më gojë.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, V.H (më tej referuar vetëm Ankuesi), më datë 13.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër reference Ref: DBN-MM-956/2025, të datës 07.11.2025, lidhur me anulimin e konkursit më numër të referencës RN00018499, gjegjësisht, pozitën Udhëheqës i Sektorit për Integritet Euro-Atlantike, të shpallur nga Ministria e Mbrojtjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mbrojtjes, ndërsa kjo e fundit, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7361/2025, të datës 13.11.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Ref: DBN-MM956, të datës 07.11.2025; Njoftimin e datës 06.11.2025; Njoftimin e datës 29.10.2025; Njoftimin për pozitat e shpallura; Komunikimet elektronike të datës 05.11.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankese të datës 20.11.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 01.12.2025 së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit; Shpalljen e pozitave të reja rekrutuese 19.08.2025; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës; Konkursin me numër reference RN00018499; Vendimin Nr.3/627/2025 të datës 29.09.2025 së bashku me Akt emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimti; Listën e aplikantëve; Vendimin e datës 08.10.2025; Formularët e vlerësimit të esëve për kandidatët e Komisionit të Pranimti; Aplikacionin e Ankuesit me datë aplikimi 01.09.2025 së bashku me dokumentet e bashkangjitura.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankueses është e bazuar, **sepse:**

I. Gjendja e fakteve

Nga provat e administruara rrjedhë se:

- Më datë 25.08.2025 Ministria e Mbrojtjes(MM) më datë25.08.2025, ka shpall konkursin më numër të referencës RN00018499, pozita Udhëheqës i Sektorit për Integritet Euro-Atlantike, me afat aplikimi nga data 26.08.2025 deri më datë 24.09.2025.
- Në këtë procedurë rekrutimi kishte aplikuar edhe ankuesi dhe së i njëjti kishte kaluar fazën e verifikimit paraprak si kandidat që ka plotësuar kriteret formale, gjegjësisht, procedura kishte vazhduar më verifikimin paraprak dhe mbajtjen e testimit më shkrim më datë 22.10.2025.
- Drejtoria e Burime Njerëzore të MM-së më Vendimin me numër Ref.DBN-MM-956/2025 të datës 07.11.2025, ka anuluar procedurën e rekrutimit më numër të referencës RN00018499, për pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për Integritet Euro Atlantike, më arsyetimin së anulimi behët mbi bazën e kërkesës së Zëvendës ministrit të MM-së të datës 31.10.2025, përmes së cilës ishte kërkuar: ” *Meqenëse MM është në proces të ristrukturimit dhe një gjë e tillë është prioritet mbi prioritetet posa të formohet qeveria e re, kërkoj që të gjitha pozitat që janë në proces të rekrutimit të anulohen deri në një vlerësim të ri mbi nevojat e strukturës së re të MM-së*”.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill kundërshton Vendimin Ref.DBN-MM-956/2025 të datës 07.11.2025 për anulimin e konkursit me nr.ref: RN00018499, më pretendimin së anulimi është pa ndonjë bazë ligjore dhe si i tillë është juridikisht i pavlefshëm. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën të shfuqizoj vendimin e kundërshtuar më ankesë dhe të urdhëroj Ministrinë e Mbrojtjes që të vazhdoj për procedurën e kontestuar të rekrutimit.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, lidhur me këtë çështje ankimore ka shqyrtuar kompetencën ligjor si dhe bazueshmërinë e anulimit të konkursit me nr.ref: RN00018499. Rrjedhimisht, në këtë kontekst Kolegji iu referua Ligjin nr. 06/1 -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, më theks të veçantë:

- **nenit 3:** *Administrata publike ushtron veprimtarinë e saj në bazë të Kushtetutës, ligjit dhe legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës*”;;

- **nenit 16:** *Zëvendësministri ndihmon ministrin dhe është pjesë e hierarkisë administrative dhe zëvendëson ministrin në rastet e mungesës së tij të përkohshme apo për përgjegjësitë e deleguara shprehimisht nga ministri*”;

- **nenit 18:** 1. *Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil i ministrisë, përgjegjës për drejtimin e të gjithë veprimtarisë administrativo-profesionale të sistemit ministror.* 2. *Sekretari i Përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit dhe ushtron detyrën nën drejtimin dhe udhëzimet e ministrit.* 3. *Sekretari i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi kryesore:* 3.1. *mbështet ministrin në punën e tij;* 3.2. *siguron koordinimin e hartimit të politikave në ministrinë përkatëse;* 3.3. *siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit, të politikave dhe të vendimeve të ministrit;* 3.4. *siguron drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e të gjithë sistemit ministror;* 3.5. *siguron bashkëpunimin me ministri të tjera dhe institucionet, si dhe me agjencitë e pavarura;* 3.6. *vendos për administrimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore, të sistemit ministror, në përputhje me legjislacionin në fuqi;* 3.7. *çdo përgjegjësi tjetër, që i caktohet me ligj apo të deleguar shprehimisht nga ministri.*

Bazuar në kuadrin ligjor si më lartë si dhe duke u bazuar në dispozitat e Ligjit N.08/L-117 për Qeverinë Republikës së Kosovës rrjedhë fakti së Ministri dhe Zv.Ministri janë organe në hierarkinë e administratës shtetërore të cilët marrin pjesë drejtpërdrejt në hartimin e politikave publike të cilat impelmentohen nga dikasteri ministror i caktuar, pra, të njëjtit nuk kanë kompetencë në kuptim të menaxhimit të burimeve njerëzore, pasi që një kompetencë e tillë bie në fushën e veprimit të Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë përkatëse si Zyrtar Kryesor Administrativ.

Rrjedhimisht, duke u bazuar në nenin 17 dhe 39 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyratë Publike çdo institucion që punëson zyrtarë/ë publik, përgatit planin vjetor të personelit në pajtim me procesin e planifikimit buxhetor, plan që hartohet për të gjitha kategoritë e zyrtarëve/ëve publik dhe përmban analizën e nevojave për personel; nevojat për zhvillimin profesional dhe trajnim të stafit ekzistues; si dhe afatet e plotësimit të vendeve të reja dhe/apo lira të punës, ndërsa, si organe përgjegjëse të përfshira në procedurën e rekrutimit janë Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (fazën e verifikimit paraprak) dhe Komisionin e Pranimi (faza e vlerësimit profesional). dhe se rrjedhojë vetëm këto dy organe kanë të drejtën që të përfundojnë dhe anulojnë një proces rekrutimit dhe atë vetëm mbi bazën kur vërehen dhe konstatohen shkelje dhe tejkalime ligjore që si të tilla procedurën e caktuar të pranimi e karakterizojnë si të paligjshme.

Andaj, në kuptim të konstatimeve si më sipër, Kolegji erdhi në përfundimin së anulimi i konkursit më numër reference RN00018499 mbi arsyet sikurse në Vendimin Ref.DBN-MM-956/2025 të datës 07.11.2025 të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të MM-së nuk përbën shkak ligjor të arsyeshëm për anulim të konkursit, sepse siç u tha më lartë anulimi i një procedurë rekrutimi në zhvillim e sipër mund të ndodhë vetëm në rastet e shkelje procedurale dhe materiale, rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit anulimi i procedurës më numër reference RN00018499 mbi bazën e shkresës së zëvendës ministrit të datës 31.10.2025 cenon rëndë të drejtat e kandidatëve në këtë procedurë dhe se një akt i tillë administrativ bie ndesh me parimet bazë të procedurës administrative të përcaktuara më Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me theks të veçantë: **Nenin 4: Parimi i ligjshmërisë** 1. *Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.* 2. *Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj.* 3. *Nëse ligji autorizon organin publik të ushtrojë pushtet diskrecionar në një vendimarrje (në vijim “diskrecioni”), ai do të ushtrohet në mënyrë të ligjshme vetëm nëse plotësohen këto kushte: 3.1. nuk tejkalon kufijtë e përcaktuar në ligjin që lejon diskrecionin; 3.2. zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin për të cilin ligji e parashikon diskrecionin dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Ligji, në veçanti me parimin e proporcionalitetit, dhe 3.3. zgjedhja e organit publik nuk është në kundërshtim me normat e gjithëpranuara të shkencës apo teknikës dhe nuk shkel parimet themelore të drejtësisë apo arsyes njerëzore.* 4. *Pushteti diskrecionar, përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, është mundësia që i jepet një organi publik, shprehimisht apo që nënkuptohet me ligj, për të vendosur duke zgjedhur në mes dy apo më shumë veprimeve të ligjshme, për t’i shërbyer në mënyrën sa më të përshtatshme interesit publik.* **Neni 5: Parimi i proporcionalitetit** 1. *Një veprim administrativ, që për arsye të mbrojtjes së interesit publik kufizon apo cenon të drejtat apo interesat juridike të një personi, duhet të jetë në pajtim me parimin e proporcionalitetit.* 2. *Një veprim administrativ është në pajtim me parimin e proporcionalitetit vetëm nëse i plotëson këto kushte: 2.1. është i domosdoshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj; 2.2. është i përshtatshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj, dhe 2.3. kufizimi apo cenimi i të drejtës apo interesit juridik nuk është në shpërpjestim me realizimin e qëllimit të ndjekur.* **dhe Neni 8: Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme** 1. *Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave.* 2. *Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme.*

Bazuar në konstatimet dhe të gjeturat si më sipër, Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi që të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj Vendimit Ref. DBN-MM- 956/2025, të datës 07.11.2025, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, duke obliguar Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorinë se Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmarrin çdo veprim të nevojshëm në mënyrë që procedura e pranimi më numër të referencës RN00018499 të vijoj më intervistën më gojë të kandidatëve. Kështu që, thënë si më sipër e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.1902/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, V.H;
- *Organit të punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes; dhe*
- Arkivit të KPMSHCK-së.